

L I G J
Nr.7988, datë 13.9.1995

PËR PAGAT E GJYKATËS SË APELIT USHTARAK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pagat e Gjykatës së Apelit Ushtarak të jenë të njëjta me ato të Gjykatës së Apelit Civil për funksionet kryetar, zëvendëskryetar dhe gjyqtarë.

Neni 2

Pagat sipas paragrafit të dytë të pasqyrës nr.4 bashkëngjitur ligjit nr.7800, datë 2.3.1994 “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve” për Gjykatën e Apelit Ushtarak, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 korrik 1995.

Shpallur me dekretin nr.1212, datë 25.9.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha